



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI



Nr. 3427 Prot

Shkodër, më 28. 10. 2024

NJ O F T I M

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" shpallet konkursi për një vend të lirë pune, për kategorinë staf akademik pranë Fakultetit të Shkencave Shoqërore, Departamenti i Historisë, në pozicionin lektor/e me kohë të plotë për vitin akademik 2024-2025, programi i studimit bachelor në "Gjeografi", MSH në "Studime të historisë dhe të kulturës shqiptare" për leksionet dhe seminarët e lëndëve "Histori antike e botës", "Histori e vjetër dhe e mesjetës" dhe "Etnografi".

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kriterë specifike :

1. Të kenë kryer të gjitha ciklet e studimit në fushen e "Historisë" në sistemin me kohë të plotë.
2. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 6 (Bachelor/Program studimi i nivelit të parë), duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë) dhe nota mesatare e grupit të lëndëve për të cilat konkurrohet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë).
3. Nota mesatare e përgjithshme e studimeve që në nivelet e kornizës shqiptare të kualifikimeve (kshk) i përket nivelit 7 (Master i Shkencave, Master i arteve/Master i arteve të bukura/Program studimi i nivelit të dytë, Program studimi i integruar i ciklit të dytë ose Program studimi 4-vjeçar) duhet të jetë jo më e ulët se 8.5 (tetë pikë pesë) dhe nota mesatare e grupit të lëndëve për të cilat konkurrohet të jetë jo më e ulët se 9 (nëntë).
4. Të kenë mbaruar studimet që në nivelin e kornizës së kualifikimeve (kksh) i përket nivelit 8 (Doktoratë, Shkollë pasuniversitare studimesh të thelluara ose të ketë titullin Docent).
5. Kandidati që konkuron duhet ti ketë dhënë domosdoshmërisht provim lëndët për të cilat pretendon të jetë mësimdhënës.
6. Të njohë një nga pesë gjuhët e huaja të BE-së, me notë jo më të ulët se 8 (tetë) të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose të njohur nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për gjuhët në nivelin C1. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.
7. Të kenë eksperiencë pune në mësimdhënie në arsimin e lartë.
8. Të kenë botime.

Kandidatët për pedagogë duhet të plotësojnë këto kriterë të përgjithshme :

1. Të kenë zotësi të plotë për të vepruar.
2. Të zotërojnë aftësi profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurrojnë.

3. Të kenë aftësinë e punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
4. Të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata për kryerjen e një vepre penale.
5. Të mos jenë larguar nga USH "L.Gurakuqi" pa miratimin e këtij të fundit.
6. Të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna.
7. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH "L.Gurakuqi".
8. Të mos kenë lidhje familjare (bashkëshort/bashkjetues, bir, bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie (prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre) me punonjës ekzistues brenda të njëjes njësi bazë/drejtorisë ku kërkojnë të punësohen.

Kandidatët për pedagogë duhet të paraqesin këto dokumente :


1. Të aplikojë "on-line" në faqen zyrtare të USH në internet në adresën www.unishk.edu.al (rubrika Njoftime për punësim- pedagog të brëndshëm)
2. Letër-motivimi dhe jetëshkrim (CV) me foto personale.
3. Fotokopje të noterizuara të diplomave universitare (Bachelor dhe MSH ose DIND) në specialitetin e lartpërmendur dhe lista përkatëse e notave të noterizuara. Për diplomat e fituara në universitetet e huaja, duhet të dorëzohet certifikata e njohjes nga MASR.
4. Fotokopje e noterizuar e gradës shkencore "Doktor" në specialitetin e lartpërmendur dhe/ose tituje akademikë (nëse ka të tilla).
5. Tre rekondime nga të cilat të paktën dy prej mësimdhënësit me tituj shkencorë në profilin përkatës dhe një rekondim nga punëdhënësi i fundit.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi e gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga institucionet shtetërore ose fotokopje e noterizuar.
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesëmarrje në konferanca, seminare, workshop etj.
9. Dëshmi e gjendjes gjyqsore (dëshmi penaliteti + vërtetim gjykate + vërtetim prokurorie + vërtetim nga zyra e përbartur).
10. Dëshmi e gjendjes mjeksore (kartë shëndeti + librezë shëndetsore + raport mjeko-ligjor për aftësi në punë + certifikatë vaksinimi anti-Covid)
11. Vërtetim nga qëndra e punës në të cilën ka punuar ose punon (fotokopje e noterizuar e librezës së punës nëse ka) dhe/ose vërtetim papunësie nga Zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c të nenit 5 të rregullores së posaçme të Universitetit "Për punësimin në USH" (për mos-lidhje farefisnore).
13. Certifikatë familjare dhe fotokopje e pasaportës ose letërnjoftimit ID.
14. Vërtetim rajoni për adresen/rezidencen e banimit (kontratë qiramarje).

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat të pacaktuar.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë me postë pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e mësipërm bashkë me një listë përbledhëse të këtij dokumentacioni të firmosur, brenda dy javëve nga publikimi i njostimit në Buletinini e Agjensisë së Prokurimit Publik.
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, dhe/ose testim, dhe/ose intervistë brenda tri javëve nga publikimi i njostimit, sipas orarit që do të përcaktojë departamenti përkatës.
- Kandidatët që kualifikohen do të njostohen me e-mail nga kryetari i komisionit ad-hoc.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit dhe ora e saktë t'i drejtoshën dekanatin përkates dhe/ose Sektorit të Burimeve Njerëzore në Rektorat.

R E K T O R I

Prof. dr. Tomi GJERAJ





REPUBLIKA E SHQIPÉRISË

UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI



Nr. 3427 / Prot

Shkodër, më 29. 10. 2024

Lënda: Publikim njoftimi në Buletin e Njoftimeve Publike

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

(Adresa : Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"- Këshilli i Ministrave)

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin e deritanishëm, bashkëlidhur po ju dërgojmë njoftimin tonë për publikim në Buletin e Njoftimeve Publike të rradhës për një vend pune.
Sipas kërkesës tuaj, po ju dërgojmë edhe "CD" me variantin elektronik të njoftimit.



